



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Komisioni për Buxhet dhe Financa dhe
Mbledhja nr. 34/18
Prishtinë, më 26.10.2018, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, salla N-10

PROCESVERBAL

Në mbledhjen e përbashkët morën pjesë: Lumir Abdixhiku, Safete Hadergjonaj, Jelena Bontic, Naser Osmani, Mërgim Lushtaku, Dardan Molliqaj, Ali Lajçi, Arbërie Nagavci, Enver Hoti, Blerim Kuçi dhe Fikrim Damka.

Pjesëmarrës i ftuar: Fatmir Gashi - Zëvendësministër i Financave.

Pjesëmarrësit tjerë: Vatra Çehaja nga GPLVV, Këshilltar në GPAAK, Albulena Bytyçi – Gazetare në RTK, Dardane Neziraj – Gazetare nga Koha Ditore, Lorentë Aliaj nga KDI, Emirjeta Vllahu – Gazetare nga Kallco.com, Suzan Bytyçi-Jagxhiu nga Zyra e BE-së.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Iseini, Luljeta Krasniqi dhe Dashurije Canolli.

Mbledhjen e kryesoi: Lumir Abdixhiku – Kryetar (tutje kryetari).

Rendi i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur e Komisionit, dt. 17.10.2018;**
- 3. Shqyrtimi i kërkesës së Qeverisë së Kosovës për konsultim me Komisionin për Buxhet dhe Financa, lidhur me Vendimin e Qeverisë për ndryshimin e normës së tatimit të akcizës;**
- 4. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-007 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-007 për procedurën jokontestimore dhe amendamenteve të Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit;**
- 5. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-008 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.2004/26 për trashëgiminë në Kosovë dhe amendamenteve të Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit;**
- 6. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari: Propozoi që rendi i ditë të plotësohet me dy pika të reja: Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-077 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.2004/32 për familjen i Kosovës dhe Caktimi i Grupit Punues për shqyrtimin e Projektligjit për tatimin në të ardhurat personale dhe Projektligjit për tatimin në të ardhurat e korporatave.

Kryetari: Konstatoi se Komisioni unanimitisht miratoi rendin e ditës me plotësimin e dy pikave të reja, të renditura si pika 6 dhe 7, me tekstin si vijon: Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-077 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.2004/32 për familjen i Kosovës dhe Caktimi i Grupit Punues për shqyrtimin e Projektligjit për tatimin në të ardhurat personale dhe Projektligjit për tatimin në të ardhurat e korporatave.

2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhja e mbajtur e Komisionit, dt. 17.10.2018

Kryetari: Konstatoi se Komisioni unanimitisht miratoi procesverbalin nga mbledhja e mbajtur e Komisionit, dt. 17.10.2018, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i kërkesës së Qeverisë së Kosovës për konsultim me Komisionin për Buxhet dhe Financa, lidhur me Vendimin e Qeverisë për ndryshimin e normës së tatimit të akcizës

Kryetari: në bazë të Ligjit nr. 03/L-220 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-112 për tatimin e normës së akcizës në Kosovë, Qeveria e Kosovës në konsultim me Komisionin për Buxhet dhe Financa, mund ta ndryshojë normën e akcizës apo shtojë listën e mallrave që do të nënshtrohen normës së akcizës. Qeveria ka marrë një vendim të cilin e ka proceduar në komision për konsultim, për të cilin është i ftuar zv.ministri për të dhënë sqarimet dhe arsyetimet e nevojshme. Në ndërkohë, kemi marrë edhe një letër të shkruar nga Zyra e BE-së në Kosovës që është deklaruar se është kundër vendimit të Qeverisë, për shkak se është në kundërshtim me MSA-në.

Fatmir Gashi: Theksoi se në muajin shkurt të këtij viti, Zyra e Kryeministrit ka marrë një letër nga Oda Ekonomike e Kosovës e cila ka bashkangjitur një analizë të detajuar në lidhje me situatën e industrisë së duhanit dhe përmes kësaj është kërkuar nga Qeveria e Kosovës që të këtë mbështetje për këtë industri dhe pas kësaj Qeveria në muajin Prill të vitit 2018 ka caktuar komisionin përgjegjës dhe është formuar grupi punues i cili ka punuar në koncept dokumentin. Grupi Punues pasi hartoi koncept dokumentin, organizoi një diskutim publik të brendshëm dhe të jashtëm. Ka marre disa vërejtje, ndër të cilat kanë qenë edhe nga Komisioni Evropian dhe nga Dogana e Kosovës, të cilave iu kemi përgjigjur. Grupi Punues, pasi që ka bërë hulumtimin ligjor dhe hulumtimin e Direktivave Evropiane, ka hartuar koncept dokumentin përfundimtar dhe e ka proceduar në Qeveri për miratim.

Në kuadër të BE-së, në vazhdimësi stimulohet sektori i bujqësisë, përjashtim këtu nuk bënë as industria e prodhimit të duhanit e cila është stimuluar përmes masave të ndryshme të mundshme të këtij shkaku. Direktiva e Këshillit të Evropës nr. 2011/64 jep udhëzime të qarta për zhvillimin e kësaj industrie në vendet e BE-së, gjithmonë duke vlerësuar karakteristikat e zhvillimit ekonomik të vendeve dhe zonave më të pazhvilluara ekonomike.

Sa i përket rajonit, Maqedonia aplikon subvencionet e prodhimit të duhanit dhe cigareve për çdo kg duhan të prodhuar në atë vend, prodhuesit në varësi të kualitetit marrin deri në 1.2 euro për 1 kg, për më shumë Qeveria garanton mbledhjen dhe grumbullimin e duhanit nga prodhuesit dhe në raste se kompanitë e autorizuara nuk arrijnë të blejnë një gjë të këtillë apo falimentojnë, atëherë blerjen e kryejnë nga buxheti i shtetit.

Në Maqedoni, aplikohen metoda të ndryshme për të mbështetur industrinë e duhanit, siç janë: çmimet e garantuara për shitjen e duhanit, përkrahja financiare prej kompanisë që e blenë duhanin etj. Normat doganore më të ulëta fillojnë nga 10 % dhe shkojnë deri në 60% në vlerën e importit.

Shqipëria i ka dy nivele të akcizës, e ka akcizën për duhanin të përpunuar jashtë 4400 lekë dhe brenda 2500 lekë. Në Serbi i kemi tri raste të shitjes së tri kompanive të mëdha për prodhimin e duhanit dhe në tri fabrika. Në marrëveshjen për shitblerjen e këtyre tri fabrikave është e shkruar ku mbrohet tregu i brendshëm me anë të politikave doganore dhe Serbia ju ka garantuar që këto kompani mund të vijnë dhe ata i mbrojnë dhe e kanë doganën deri në 56% në importet e duhanit që do të thotë përdoret masa mbrojtëse.

Duke i shikuar të gjitha këto praktika dhe duke parë Direktivën e BE-së, dhe duke shikuar edhe MSA-në dhe nenin 43 i cili thotë se në qoftë se importi i një produkti dëmton në masë të madhe produktin vendor, atëherë shteti ka të drejtë të marrë masa për rregullimin e kësaj çështje dhe për mbrojtjen e asaj industrie dhe i tregon procedurat se si duhet të vazhdohet në lidhje me mbrojtjen e saj. Në bazë të analizë së shpjeguar dhe të paraqitur në koncept dokumentin, Grupi Punues, i ka propozuar Qeverisë së Kosovës që të rregullon dy çështje. Epara të rregullohet mënyra e subvencionimit të mbjellësve të duhanit, dhe në këtë drejtim kemi rekomanduar që qeveria të bëjë rregulloren e subvencioneve për duhanin dhe të subvencionojë nga 1,000 euro për prodhuesit e duhanit. Ministria e Bujqësisë është duke punuar në draftimin e atij udhëzimi i cili i rregullon çështjen e subvencionimit të duhanit. Çështja e dytë që ka rekomanduar Grupi Punues për Qeverinë, është që norma e akcizës për cigaret e prodhuara në Republikën e Kosovës t[ë] përllogaritet duke përdorur metodën sipas vlerës (ad valorem) dhe përllogaritja bëhet në çmimin e shitjes me pakicë me 30% në vlerën shitëse me pakicë.

Unë e kuptoj shqetësimin e Bashkimit Evropian ata kanë të drejtë të mbrojnë MSA-në, mirëpo duhet ta mbrojnë në mënyre reale dhe të na japin hapësirë si shteteve të tjera. Ky është vendim i përkohshëm i cili me kohë do të fillon dhe të harmonizohet me Direktivat dhe me MSA-në.

Kryetari: Siç theksova, kemi marrur një letër prej Zyrës së Bashkimit Evropian me të cilën kundërshtohet Vendimi i Qeverisë dhe i kërkon Qeverisë që ta tërheq atë vendim, pasi që është në kundërshtim me MSA-në. MSA nuk është dokument vetëm i BE-së, është marrëveshje bilaterale BE-Kosovë. Në marrëveshjen tregtare dypalëshe mendimi i palës tjetër është i vlefshëm gjithsesi, përndryshe nuk do të jetë marrëveshje bilaterale, por do të jetë e njëanshme. A keni pasur konsultime me BE-ne për këtë çështje?

Fatmir Gashi: Sipas Rregullores së Qeverisë për hartimin e koncept dokumentit, ne kemi bashkangjitur vendimit, deklaratën e ndikimit buxhetor, opinionin për harmonizim me legjislacionin e BE-së nga Ministria e Integriteteve Evropian, e cila ka dhënë përgjigje pozitive. Ndërsa Ministria e Financave ka vlerësuar se në vitin e parë kostoja buxhetore është 300 mijë euro për subvencionim dhe shkon duke u rritur dhe maksimumi është 900 mijë euro në tri vitet e ardhshme. Me Zyrën e BE-së nuk kemi diskutuar, pasi që ne si Grup Punues nuk mundemi me bë këtë gjë, duhet në nivel të Qeverisë të diskutohet.

Blerim Kuçi: Theksoi për atë që jam në dijeni është një hulumtim parlamentar që komisioni për buxhet dhe financa e ka kryer në vitin 2016 lidhur me akcizën dhe çështjen e subvencionit të duhanit në Kosovë. Hulumtimi tregon mundësin e krijimit të 15.000-18.000 vende të punës me duhan. Por ajo që për mua është më rëndësi zëvendës-ministër është a ka bazë ligjore? A ka implikime në të hyrat buxhetore, a i rritë apo i zvogëlon të hyrat? Neni 39 i MSA-së ka të bëjë me formën e mbledhjes së akcizës. Ne po krijojmë dy lloje të akcizës. MSA kanë ratifikuar edhe shtetet tjera. Në Serbi, Krocaci nuk është ndalur kjo mundësi deri në hyrjes në BE. Për neve është më rëndësi qytetarët a po përfitojnë me këtë vendim? Kjo çështje nuk lidhet fare me liberalizimin e vizave.

Naser Osmani: Lidhur me hulumtimin parlamentar që përmendi deputeti Kuçi, në mandatin e kaluar kemi formuar një grup punues për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit, të cilin e ka kryesuar ish deputeti Bardhyl Meta dhe ideja ka qenë me ndryshuar ligjin për duhanin, sepse ligji për duhanin është krijuar në Kosovë në momentin më të papërshtatshëm dhe ka qenë një ligj i disfavorshëm për prodhuesit e duhanit, sidomos në pjesën e Gjakovës dhe të Gjilanit që kanë pasur një traditë të kultivimit të duhanit. Edhe ky komision ka punuar fortë në këtë drejtim, por për fat të keq për shkak të zgjedhjeve nuk është kryer puna.

Tani që po diskutojmë këtë çështje, kemi të bëjmë me ndryshimin e konceptit të vënies së akcizës për duhanin. Këtu është dashur që ministria të na e sqaroj pak më mirë që ta kuptojmë kohën dhe si do të ndikohet buxheti me këtë ndryshim. A ka këso lojë llogaritje sepse nuk mundemi me kamufluar asgjë në emër të asaj që po ndihmojmë në kultivimin e duhanit sepse duhet te ndryshojmë ligjin për të përkrahur një gjë të tillë. Tani kemi të bëjmë me kodin doganor, ndryshimin e normave doganore që ka të bëjë me duhanin. Ne jemi me i përkrahur prodhimet vendore, por duke respektuar gjithmonë konkurrencën sepse na obligon edhe Kushtetuta dhe ligjet. Ndërsa, çështja e MSA-së mendoj se duhet të jetë përgjegjësi e Qeverisë sepse këta e kanë nënshkruar atë marrëveshje dhe duhet të bashkëpunojnë ngushtë me BE-në, sa i përket respektimit të marrëveshjes.

Dardan Molliqaj: Besojë që në disa pika ndajmë vlerësime të njëjta sepse industria e përpunimit të duhanit në Kosovë mund të jetë një sektor jo aq përcaktues por një sektor i cili mund të luan një rol sado të vogël në punësim dhe zhvillim të sektorit industrial në Kosovë. Në këtë drejtim, duhet që shteti po ashtu të krijoj kushte për të subvencionuar ose krijuar lehtësira të tjera për prodhuesit, edhe për këtë besojë që ekziston koncenzues. Siç po e shohë unë dallimet janë në dy pika. E para rruga që është zgjedhur dhe e dyta mungesa e Qeverisë për të negociuar me Zyrën e BE-së në Kosovë, sa i përket MSA-së.

Ne kemi hyrë në një marrëdhënie kontraktuale bilaterale siç tha edhe kryetari me BE-në, sa i përket MSA-së dhe duhet të sillemi konform asaj marrëveshje. Besoj që ka gabuar qeveria që nuk e ka negociuar deri tash me Bashkimin Evropian këtë çështje, sepse po e shoh që të gjitha faktet na japin të drejtë që edhe BE, të mos ketë një problem të tillë me ne.

Me aq sa unë kam pa është akciza sot thuajse për pako të duhanit shkon mbi 80 cent dhe më këto ndryshime që janë propozuar ad valorem prej 30% e vlerës së shitjes të njësisë që i bie për një pako të paguajmë 30 cent për akcizën.

Përkundër vërejtjeve që i thashë, unë mendoj që ne duhet të përkrahim në parim vendimin e Qeverisë, por shpresojë shumë që Qeveria do ta marrë seriozisht çështjen e negociimit me Zyrën e BE-së në kuadër të MSA-së, përndryshe do të jetë vetëm një vendim në letër nga ne.

Safete Hadergjonaj: Unë jam shumë për me pasur politika favorizuese dhe me ndikuar në zhvillimin e bujqësisë dhe prodhimtarisë vendore, mirëpo forma se si ka ardhur ky vendim nuk me duket shumë i qëlluar.

Unë jam e vetëdijshme që një formë e tillë e përcaktimit të politikave nuk ka reflektuar pozitivisht në Kosovë për arsye se niveli i prodhimit vendor ka qenë shumë i ulët dhe gjithçka është importuar për ti plotësuar kërkesat e brendshme nga jashtë. Janë rritur importet me këto politika dhe kemi një disbalancë dhe një gjendje e tillë e pafavorshme për ekonominë tonë dhe sinqerisht po them se duhet ulur të gjithë akterët të cilët merren me problematikën ekonomike për të gjetur formën më të përshtatshme të politikave zhvillimore në vendin tonë. Jo te diskutohet vetëm kjo çështje, por të diskutohen të gjitha çështjet të cilat e avancojnë zhvillimin ekonomik te vendit.

Unë jam marrur shumë me politikat e zëvendësimit të importeve, dhe politikat e zëvendësimit të importeve duke vënë taksa dhe tatime kanë rënë poshtë. Ne duhet të gjejmë mënyrën që ta stimulojmë prodhimin vendor, por duke mos vënë tatim dhe taksa në importet e produkteve të cilat vijnë në Kosovë. Nga ana tjetër çdo vendim i cili vjen për të zhvilluar prodhimtarinë vendore unë do të jem pro dhe do të jem e angazhuar në maksimum për të përkrahur, për të stimuluar prodhimtarinë vendore, për t'i

plotësuar kërkesat tona të brendshme, dhe në këtë formë të zvogëlohet kërkesa për produkte të importuara përmes rritjes së prodhimit të vendore.

Ne mund të bëjmë veprime të njëanshme, mirëpo ato pastaj po na kthehen si bumerang. Meqenëse këtu e kemi një shkresë që na ka ardhur nga Zyra e BE-së dhe unë e di që Qeveria e ka analizuar këtë çështje dhe e ka parë që bie në kontradiktë me nenin 39 të MSA-së, dhe unë mendoj se nuk kemi nevojë që të futemi në kontradiktë me BE-në dhe të marrim vendime të tilla të cilat mendoj që nuk do të jenë të zbatueshme dhe nuk janë efektive për ne si vend.

Nuk e di sa fabrika të duhanit punojnë në Kosove. A është ndonjë fabrikë që punon në Kosove që mirret me prodhimin e duhanit? Ne duhet të jemi të kujdesshëm që vërtetë ka plotë produkte në bujqësi të cilat kemi nevojë për ti subvencionuar, për të ndarë grante për ato, kemi nevojë ndoshta me ndarë grante edhe për të bërë prodhimin e duhanit. Mirëpo, me venë tatime dhe taksa në kundërshtim me qëndrimet e Bashkimit Evropian, unë mendoj që nuk është politikë e menduar mirë. Prandaj, kisha dashur që ta riktheni edhe njëherë në qeveri vendimin, ta diskutoni, ta analizoni, të diskutoni me Bashkimit Evropian, të gjeni hapësirë brenda dispozitave ligjore të MSA-së dhe kur ti shtëroni të gjitha këto diskutime, të shohim se çka duhet të bëjmë.

Dardan Molliqaj: Janë dy çështje. E para MSA-në nëse e keni lexuar zonja Hadërgjonaj, për disa produkte që prodhohen në Kosovë, mundëson që të mbrohen për 10 vite, 15 vite, 5 vite dhe 3 vite dhe MSA-ja kur negociohet një prej temave më të nxehta të saj është për cilat produkte të lejohen me i mbrojt dhe për sa vite. MSA parasheh që të negociohen produktet që do ti nënshtrohen doganave dhe akcizës.

Ajo çka unë mundem me u pajtue me ju dhe me secilin është që Qeveria është dashur me negociue tashmë me BE-në për një hapësirë të tillë që lejon MSA. Është konstatim i saktë, jo vetëm në Kosovë se industria e duhanit bënë pjesë ndër industritë që financon shumë subjektet politike. Ajo çka di aktualisht është që kompanitë e mëdha të cilat importojnë duhan në Kosovë kanë lobuar për këtë çështje sepse ato janë të interesuara të kenë tregun nën kontroll. Kjo që është propozuar është një mini mbrojtje për disa prodhues të vegjël të cilët e ndihmojnë Kosovën, duke e ndihmuar prodhuesin vendor e shumë pak i dëmtojnë interesat e kompanive të mëdha sepse janë të shtrira në të gjithë botën. Nuk është vendosur taksa për import, por është vendosur lirimi për cigaret e prodhuara në Kosovë. Po besojë zonja Hadërgjonaj, se mendimi juaj është personal dhe jo i ndikuar dhe shpresojë se nuk është qëndrimi i krjetë PDK-së, pasi që kjo tregon se mbrapa kësaj qendrojnë kompanitë e mëdha të duhanit.

Safete Hadërgjonaj: Me vjen keq që z.Dardan i kthen gjërat në konceptin e mendjes tij. Unë po ta them me përgjegjësi që me asnjë individ të politikës, të partisë time apo të ndonjë përsone tjetër nuk kam kontaktuar lidhur me këtë çështje. Çështja është se kemi një shkresë përpara nga Zyra e BE-ku përmendet se me këtë propozim shkelet neni i caktuar i MSA-së. Unë jam më i përkrah prodhimet vendore, për subvencioneve dhe formave tjera, por nuk jam e interesuar me ra në kundërshtim me BE, sepse nuk na qojnë askund këto politika.

Dardan Molliqaj: Zonja Hadërgjonaj, para një jave në këtë komision ka votuar një vendim kundër kërkesës së BE-së, lidhur me vjetërsinë e veturave, që ishte propozim i deputetit Lushtaku. Pra mos thuani se çfarëdo që thotë BE-ja e përkrahu, sepse e dematuat veten me atë çfarë keni vepruar para një jave. Ndërsa unë kam edhe atëherë kam thënë se për vjetërsinë e veturave, bindjet e mija përshtaten me qëndrimin e BE-së kam votuar, ndërsa sot nuk pajtohem me qëndrimin e BE-së dhe po votojë ndryshe.

Safete Hadërgjonaj: Po me vjen për këtë qasje të deputetit Dardan, pasi që për projektligjin për vjetërsinë e veturave, nuk kam pasur shkresë përpara nga BE-ja dhe po e thëmë me përgjegjësi të plotë, sikurse të kisha pasur një shkresë të tillë nga BE-ja, sikur e kemi këtë përpara me argumente të tilla, sigurisht se nuk do ta kisha përkrahur dhe nesër me sjellë BE-ja një shkresë të tillë, unë nuk do ta votojë në Kuvend një ligj të tillë.

Enver Hoti: Theksoi se është dashur që materialit ti bashkëngjitet edhe mendimi i Ministrisë së Integriteteve Evropiane, por mendojë që iniciativa dhe vendimi për me i përkrahur prodhuesit e duhanit është në interes të të gjithëve. Të gjitha vërejtjet dhe dilemat që dalin në raport me BE-në duhet diskutuar dhe zgjidhur ndërmjet palëve. Megjithatë, duhet potencuar edhe faktin se importuesit e duhanit janë shumë aktiv dhe lobues kundër një iniciativat. Ne duhet të punojnë të ndryshojmë raportet e mallrave nga ato që hyjnë brenda dhe ato që ekspertohehen. Në këtë drejtim ne do të mbështesim fuqishëm këtë vendim.

Fatim Gashi: Konsultimet shtesë me BE-në i bënë Qeveria dhe për sa e di unë ato kanë filluar. Nuk është asnjë shkelje as padrejtësi me këtë vendim. Në Direktivë janë dy metoda dhe ne kemi përdorur këtë zgjidhje. Ne po e kryejmë procesin dhe pastaj konsultimet me BE-në vazhdojnë.

Naser Osmani: Kjo nuk ka të bëjë me prodhues dhe ka të bëjë me shitjen me pakicë. Tregona zëvendësministër, sa fabrika të cigareve janë në Kosovë?

Fatmir Gashi: Ne kemi një fabrikë të duhanit në Kosovës, por me këto kushte nuk mund të funksionojë.

Safete Hadergjona: propozoi Që kërkesa e Qeverisë së Kosovës për konsultim me Komisionin për Buxhet dhe Financa, lidhur me Vendimin e saj për ndryshimin e normës së tatimit të akcizës, të shtyhet në mbledhje tjetër të Komisionit. Qeveria të harmonizoi qëndrimet me Zyrën e BE-së në kuadër të MSA-së dhe pastaj vendimi të mund të procedohet për konsultim në Komision.

Kryetari: theksoi se kemi dy propozime për votim: I pari i zëvendëskryetares së parë të komisionit për shtyrjen e votimit të Kërkesës së Qeverisë së Kosovës për konsultim me Komisionin për Buxhet dhe Financa, për një mbledhje tjetër, me qëllim të diskutimit dhe harmonizimeve të qëndrimeve me BE-në, dhe propozimi i dytë që të hedhim në votim qëndrimin e Komisionit për përkrahjen/mospërkrahjen e Vendimit të Qeverisë.

Kryetari konstatoi se Komisioni me 4 vota Për, 5 Kundër dhe 1 Abstenim, nuk përkrahu propozimin e zëvendëskryetarë së parë të Komisionit, për shtyrjen e votimit për Kërkesën e Qeverisë së Kosovës dhe harmonizimin e qëndrimeve me BE-në lidhur me këtë vendim për ndryshimin e normës së tatimit të akcizës, dhe më pas vendimi të mund të procedohet për konsultim në komision.

Ndërsa, sa i përket propozimit të dytë, për përkrahjen/mospërkrahjen e vendimit të Qeverisë, pas votimit me rezultat: 5 vota Për, 5 vota Abstenim dhe Asnjë votë Kundër, Kryetari konstatoi se në emër të komisionit, do të kërkojë një këshillë ligjore nga Administrata e Kuvendit lidhur me vlefshmërinë e votimit në këto raste. Pas marrjes së këshillës ligjore, do të nënshkruaj Përfundimin Komisionit për Qeverinë, lidhur me Propozim-Vendimin e saj për ndryshimin e normës së tatimit të akcizës.

Pas diskutimeve dhe në bazë të propozimit, kryetari konstatoi se Komisioni me 5 vota Për, 5 vota Abstenim dhe asnjë votë Kundër, për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nxori këtë

Përfundim

- I. Komisioni për Buxhet dhe Financa, nuk e përkrahu Propozim-Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 11/68, të datës 09.10.2018 për plotësimin dhe ndryshimin e Vendimit e Qeverisë nr.11/64, të datës 16.12.2015, që pas pikës 1 të Vendimit Nr. 11/64, të datës 16.12.2015, të shtohet një pikë e re me numrin rendor 1A, me tekstin si në vijim:

1.A. Norma e akcizës për cigaret e prodhuara në Republikën e Kosovës (Kodin tarifor 2402 2010 11 dhe 2402 2090 11) përllogaritet duke përdorur metodën sipas vlerës (ad valorem) dhe përllogaritja bëhet në çmimin e shitjes me pakicë me normën tridhjetë (30%) për çind në vlerën shitëse me pakicë.

4. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-007 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-007 për procedurën jokontestimore dhe amendamenteve të Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Kryetari: Në bazë të Deklaratës Financiare të përgatitur nga Departamenti i Buxhetit të Ministrisë së Financave, ky projektligj nuk përmban implikime shtesë buxhetore. As amendamentet e komisionit funksional nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

Pas përfundimit të diskutimeve dhe në bazë të propozimit, Kryetari konstatoi se Komisioni unanimisht, nxori këtë

R e k o m a n d i m

1. Projektligji nr.06/L-007 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-007 për procedurën jokontestimore, nuk përmban implikime buxhetore shtesë.
2. Amendamentet e propozuara nga Komisioni Funksional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

5. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-008 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.2004/26 për trashëgiminë në Kosovë dhe amendamenteve të Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Kryetari: Në bazë të Deklaratës Financiare të përgatitur nga Departamenti i Buxhetit të Ministrisë së Financave, ky projektligj nuk përmban implikime shtesë buxhetore. As amendamentet e komisionit funksional nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

Pas përfundimit të diskutimeve dhe në bazë të propozimit, Kryetari konstatoi se Komisioni unanimisht, nxori këtë

R e k o m a n d i m

1. Projektligji nr.06/L-008 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.2004/26 për trashëgiminë në Kosovë, nuk përmban implikime buxhetore shtesë.
2. Amendamentet e propozuara nga Komisioni Funksional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

6. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-077 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.2004/32 për familjen i Kosovës

Kryetari: Në bazë të Deklaratës Financiare të përgatitur nga Departamenti i Buxhetit të Ministrisë së Financave, ky projektligj nuk përmban implikime shtesë buxhetore. Ndërsa, për këtë projektligj nuk kemi amendamentet të propozuara nga komisioni funksional.

Pas përfundimit të diskutimeve dhe në bazë të propozimit, Kryetari konstatoi se Komisioni unanimit, nxori këtë

R e k o m a n d i m

Projektligji nr.06/L-077 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.2004/32 për familjen i Kosovës, nuk përmban implikime buxhetore shtesë.

7. Caktimi i Grupit Punues për shqyrtimin e Projektligjit për tatimin në të ardhurat personale dhe Projektligjit për tatimin në të ardhurat e korporatave

Kryetari: propozoi që të caktohet një grup punues i cili do të shqyrtojë të dy projektligjet: për tatimin në të ardhurat personale dhe për tatimin në të ardhurat e korporatave. Për përbërjen e grupit punues, propozojë: Naser Osmani (kryesues), Safete Hadergjonaj, Jelena Bontic, Ali Lajçi dhe Blerim Kuçi.

Kryetari konstatoi se Komisioni unanimit, caktoi Grupin Punues për shqyrtimin e Projektligjit për tatimin në të ardhurat personale dhe Projektligjit për tatimin në të ardhurat e korporatave, me këtë përbërje: Naser Osmani (kryesues), Safete Hadergjonaj, Jelena Bontic, Ali Lajçi dhe Blerim Kuçi. Grupi Punues përgatit raportin me rekomandime për shqyrtim në Komision.

**Mbledhja përfundoi në orën 12:05.
Përgatitur nga njësia mbështetëse e komisionit**

Kryetari komisionit,

Lumir Abdixhiku